

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “NEVI 2025” SH.P.K.**

Themeluesit:

1. **Nelsi Gega**, i biri i Kadriut , lindur në Lushnje me 16.01.1987, dhe banues në Tiranë me adresë Rruga Pjeter Bogdani Njesia Nr 5 Tirane, mbajtës i kartes se identitetit me Numër I70116059V.
2. **Elvis Burimi**, i biri i Engjëllit, lindur në Kavajë më 28.04.1987, dhe banues në Tiranë në adresën Rruga Ismail Qemali pallati 7/1 ish Blloku , mbajtës i kartes së identitetit me Numër I70428081B.

Të cilët në vijim do të quhen **Ortakët**,

Sot me datë 20.10.2025, bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar Ligjin nr. 9753 dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, vendosën të themelojnë Shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të kushteve që vijnë:

**Neni 1
Forma ligjore dhe emërtimi**

Shoqëria është një person juridik shqiptar, e cila ka formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Emërtimi i shoqërisë është “NEVI 2025” ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa sh.p.k, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin në fushat e: Ushqimit social, Bar-Restorant, Fast Food, shërbime delivery, Hoteleri Turizmit, investime ne fushën imobiliare, investime ne ndërtim

Përshkrimi i objektit të shoqërisë ka natyrë jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme. Shoqëria në çdo kohë mund të ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.



Neni 4 **Selia**

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Rezidenca Xhiardino pranë Grand Blue Fafa Golem-Durres .

Shoqëria mund të themelojë dege, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 5 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000.000 (njqindë milion) Lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Nelsi Gega zotëron një kuotë, me vlerë të përgjithshme 50.000.000 (pesëdhjetë milion)Lekë, që përbën 50% (pësëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Elvis Burimi zotëron një kuotë, me vlerë të përgjithshme 50.000.000 (pesëdhjetë milion)Lekë, që përbën 50 % (pësëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Neni 6 **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar më ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të trasferueshme me rrugë trashëgimie.



Neni 8

Organi vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit në përputhje me modalitetet e përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën "c" e "d" të kësaj pike;
- f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- gj) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti;

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asmblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 (tridhjetë) për qind të kuotave.



Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e Përgjithshme vendos me 3/4 (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve;
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12 **Përfashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur Ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku të cilin përfaqëson.

Neni 13 **Administrimi**

Shoqëria administrohet nga 1 (një) ose disa administrator bashkërisht, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërsëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i parë i shoqërisë me kohëzgjatje 5(pesë) vjet, do të jetë: Elvis Burimi i biri i Engjëllit, lindur në Kavajë më 28.04.1987, dhe banues në Tiranë në adresën Rruga Ismail Qemali pallati 7/1 ish Blloku , mbajtës i kartes së identitetit me Numër I70428081B.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve dhe kufizimi i kompetencave

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare” administratori detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe të vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrve të tij në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer, nga më shumë se një administrator ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimete mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte afëtsi paguese për të shlyer detyrimet;
 - jep kredi.

Neni 16 **Viti Financiar**

1. Viti Financiar i Shoqërisë fillon në 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.
2. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 17 **Shpërndarja e fitimeve**

Pas miratimit të pasqyrave financiare dhe në rast se janë realizuar fitime ose humbje, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen e fitimeve, krijimin e rezervave ligjore sikur edhe mbulimin e humbjeve. Pavarsisht kuotave, ndarja e fitimeve realizohet sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, kur kanë nënshkruar 100% e ortakëve të shoqërisë.

Neni 18 **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat



është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar me themelimin e saj;
- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidues dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e paaftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20 Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

Neni 21 Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Autorizohet z. **Nelsi Gega** mbajtës i kartes se identitetit me Numër I70116059V të kryejë veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Nelsi Gega

Elvis Burimi

